



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d) dhe të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 dt. 2008”), nenit 12, pika 12.5, dhe nenit 32 të Ligjit nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës (“Gazeta zyrtare e IPVQ, nr. 11. dt. 01 prill 2007”), nenit 5. të Rregullores Nr. 01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave të MAPL. Nr. 0203 – 76, të dt. 24.01.2013, dhe Nenit 8, paragrafi 1, nenit 9, paragrafi 1, pika d) të Statutit të Komunës së Pejës, 01 Numër: 09 – 8103, datë: 29. Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, pas procedurës së diskutimit publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 janar 2015, miraton:

STATUTIN E MUZEUT TË PEJËS

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1.

Më këtë statut rregullohet statusi juridik i Muzeut në Pejë (në tekstin e mëtejshëm të Muzeut), veprimtaria e Muzeut, organizimi, përfaqësimi, planifikimi, buxheti dhe transparenca.

Neni 2.

2.1. Muzeu është institucion i rëndësishëm i kulturës në komunë dhe ka për qëllim t’i shërbejë në mbamendjen dhe formimin e vetëdijes mbi historikun e trashëgimisë kulturore lëvizëse të rinisë dhe të qytetarëve me anë të artefakteve etnologjike, historike dhe arkeologjike. Si i tillë, Muzeu është qendra më e rëndësishme në grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe shërbimin e lëndëve muzeore.

2.2. Për realizimin e qëllimit, të drejtave dhe përgjegjësive që i takojnë, Muzeu vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi institucionet e Kulturës, këtë statut, politikave programore të DKRS-së, sektorit të kulturës, dhe vendimet që i miraton Kuvendi i Komunës në Pejë.

2. STATUSI JURIDIK I MUZEUT

Neni 3.

3.1. Muzeu i Pejës daton nga viti 1971. Më 1977 emërohet Muze Etnografik i Pejës, i vendosur Shtëpinë e sotme të Kulturës, kurse në vitin 1989 vendoset në Konakun e Tahir Beut. Në vitin 1992 bashkohen këto dy institucione dhe themelohet Muzeu Rajonal i Pejës. Në vitin 2000 rifillon punën Muzeu Etnologjik i Pejës dhe tani Muzeu i Pejës.

3.2. Komuna e Pejës siguron mbështetje financiare dhe ruan të drejtën e saj administrative.

Neni 4.

4.1 Selia e Muzeut është në Pejë, në hapësirat e Konakut të Tahir Beut, rruga "Eliot Engel".

Neni 5.

5.1. Emërtimi i Muzeut është Muzeu i Pejës në Pejë.

5.2. Muzeu ka status të institucionit kulturor publik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me Ligj, Statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës në Pejë

5.3. Pasuria dhe objekti është pronë e Komunës.

5.4. Në ballinën hyrëse të objektit të Muzeut vendoset mbishkrimi në gjuhën shqipe dhe gjuhët zyrtare të cilat parashihen me Ligjin për përdorimin e gjuhëve nëpër komuna

Neni 6.

Muzeu i Pejës hap xhirollogarinë e vet në njërin prej bankave të licencuara në Kosovë, pas aprovimit të këtij statute.

Neni 7.

7.1. Muzeu ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore, e cila përdoret për protokollimin e shkresave zyrtare.

7.2. Vula e rrumbullakët është me diametër 4 cm, në 3 rathë koncentrikë dhe përmban këto të dhëna:

7.2.1. Në rrethin e parë, të jashtëm, shkruhet: Republika e Kosovës,

7.2.2. Në rrethin e dytë shkruhet Komuna e Pejës, Pejë,

7.2.3. Në rrethin e tretë shkruhet: Muzeu i Pejës,

7.2.4. Në sipërfaqen e mbetur, brenda rrethit të tretë të vulës, vendoset fotografia e Konakut të Tahir Beut,

7.3. Teksti i vulës është me shkronja të mëdha shtypi, në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Kosovës,

7.4 Vula katrore e protokollit është e madhësisë 6x2.5 cm, me këtë përmbajtje, sipas renditjes:

7.4.1. Republika e Kosovës,

7.4.2. Komuna e Pejës,

7.4.3. Muzeu i Pejës,

7.4.4. Numri i protokollit i njësisë organizative, kurse në vazhdim lihet hapësirë për shënimin e numrit të protokollit të shkresës.

3. VEPRIMTARIA E MUZEUT

Funksionet dhe detyrat e Muzeut

Neni 8.

8.1. Muzeu është institucion kulturor dhe informues, që nxit të mësuarit gjatë gjithë jetës, zgjerimin e dijes dhe interesin për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe historike.

8.2 Muzeu siguron qasje të lirë në informim dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.

8.3. Muzeu është institucion kyç për koleksionimin, ruajtjen, promovimin dhe propagandimin e trashëgimisë kulturore dhe historike në Pejë.

8.4. Muzeu grumbullon materiale nga trashëgimia historike e kulturore të luajtshme dhe regjistron, përpunon, sistemon, ruan dhe mirëmban konservimin e lëndëve muzeore.

8.5. Muzeu boton katalogë dhe siguron informata materialesh muzeore me karakter historik, kulturor dhe shkencor.

8.6. Koleksionet e muzeut, krijohen nëpërmjet blerjes dhe dhurimit. Komuna përmes DKRS-së, në rekomandim të sektorit të kulturës çdo vit ndan mjete buxhetore për pasurimin e lëndës muzeore .

8.7. Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, Muzeu ka të drejtë të krijojë marrëdhënie reciproke me muzetë e komunave e tjera, Muzeu i Kosovës me qëllim bashkëpunimi në këtë fushë për dhënie të ndihmës njëra-tjetrës dhe plotësimin e veprimtarisë me koleksione, huazime dhe dhurata të ndryshme muzeore.

8.8. Muzeu i përfshirë në cilëndo formë të bashkëpunimit ndërkomunal ose me Muzeun e Kosovës, veç e veç a bashkërisht, mban përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet juridike, të cilat realizohen nga bashkëpunimi në fjalë.

8.9. Hulumton dhe mbledh material etnologjike nga kultura, materiale shpirtërore e sociale (veshje popullore, eksponate të ndryshme, fotografi, arkitektura popullore, doket e zakonet etnomuzikologji, besime e besëtytni dhe eksponate tjera arkeologjike).

8.10. Evidencon, rregullon, studion dhe përpunon lëndën muzeore.

- 8.11. Bën publikimin e lëndës etnologjike dhe arkeologjike, si dhe prezanton të dhënat për lëndën etnologjike dhe arkeologjike, qoftë në ekspozitat e përhershme a tematike, në publikimet shkencore etj.
- 8.12. Identifikon dhe dorëzon për t'u mbrojtur monumentet e lëvizshme të kulturës.
- 8.13. I incizon lëndën etnologjike në terren.
- 8.14. Merr pjesë në realizimin e programit të punës së Muzeut në tërësi.
- 8.15. Kryen edhe punë të tjera nga domeni i veprimtarisë së tij.
- 8.16. Punon katalogët, prospektet dhe publikime të tjera, të cilat kanë për qëllim paraqitjen e raporteve dhe rezultatet e arritura nga fusha e etnologjisë dhe arkeologjisë.
- 8.17. Muzeu i Pejës, hulumton, grumbullon, regjistron, publikon dhe ekspozon në ekspozitat e përhershme edhe artefakte dhe lëndë muzeore në lëmin e arkeologjisë, historisë dhe etnologjisë.
- 8.18. Etnologu dhe arkeologu çdo 6 muaj i rifreskojnë ekspozitat e përhershme etnologjike, historike dhe arkeologjike .

Neni 9.

Në kuadër të Muzeut zhvillohen edhe këto veprimtari:

- 9.1.1. Koordinimi i punëve profesionale brenda territorit të Komunës së Pejës, duke e ndarë fondin e artefakteve dhe të koleksioneve muzeore proporcionalisht, duke u bazuar në vlerat historike,
- 9.1.2. Ofrimi i qasjes në materialet muzeore me anë të ekspozitave etnologjike dhe arkeologjike për të gjithë vizitorët e saj brenda territorit të komunës edhe më gjerë,
- 9.1.3. Bashkëpunimi në përpilimin e katalogut elektronik me Muzeun e Kosovës dhe ofrimin e tij në dispozicion të qytetarëve,
- 9.1.4. Përpos bashkëpunimit me muzetë e tjerë në komuna të Kosovës dhe me Muzeun e Kosovës, bashkëpunon edhe me muzetë ndërkombëtare,
- 9.1.5. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative në ambientet e muzeut, siç janë ekspozitat e përhershme dhe të përkohshme, promovime të materialeve për zhvillimin e turizmit kulturor dhe veprimtari të tjera muzeore,
- 9.1.6. Bashkëpunimi me institucionet kulturore, shtëpitë botuese, shkollat universitet dhe komunitetin, me qëllim të nxitjes së interesimit për trashëgimin kulturore dhe historike dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës,
- 9.1.7. Prezantimi i shërbimeve dhe veprimtarive të saj për publikun me anë të uebfaqes, katalogëve, fletushkave, radio dhe TV-emisioneve dhe formave të tjera të informimit,
- 9.1.8. Përpilimi dhe botimi i publikimeve profesionale, si katalogë, doracakë, fletëpalosje, revista etj., në pajtim me ligjet dhe Statutin,
- 9.1.9. Në koordinim me sektorin e kulturës të DKRS-së, harton projekte e programe për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore e historike të Pejës,
- 9.1.10. Krijimi i stendave ekspozuese shitëse në kuadër të Muzeut të Pejës

9.11. Ushtrimi edhe i veprimtarive të tjera në pajtim me ligjet dhe këtë Statut, si dhe në pajtim me politikat zhvillimore të sektorit të kulturës në DKRS.

Neni 10.

10.1. Shërbimet që behën në muze janë me pagesë dhe

10.1. Llojet e shërbimeve me pagesë: vizitat kolektive dhe individuale, blerja e suvenireve, kartolinave, dekoreve te ndryshme dhe materialeve tjera që paraqesin trashëgimin kulturore – historike te muzeut në Pejë, çmimi për këto shërbime miratohet nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, sektorit të kulturës.

4. ORGANET E MUZEUT

Neni 11.

Organet e Muzeut janë:

11.1. Drejtori dhe

11.2. Kolegjiumi profesional.

Neni 12.

12.1. Drejtori i Muzeut zgjidhet personi, i cili, përveç kushteve te përgjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore nga fusha e shkencave të historisë dhe së paku 3 vite përvojë pune në lëmin e trashëgimisë kulturore.

12.2. Drejtori i Muzeut zgjidhet në bazë të procedurave të konkursit publik të shërbimit civil të komunës nga një komision rekrutimi, i cili paraqet mendimin për kandidatin, kurse kryetari i komunës e emëron dhe nënshkruan kontratën e punës për mandat 4-vjeçar.

12.3. Në kushtet dhe procedurat e caktuara ligjore, mund të shkarkohet edhe para periudhës për të cilin është zgjedhur

Neni 13.

Detyrat e drejtori të Muzeut:

13.1. Organizon, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Muzeut,

13.2. Propozon politikat e zhvillimit të Muzeut dhe politikat për mbështetje financiare,

13.3. Organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime dhe urdhëresa në punë,

13.4. Paraqet raportet përkatëse për rezultate të punës dhe përdorimin e buxhetit,

13.5. Përcjell problematikën e Muzeut dhe merr masa për zgjedhje më të mirë dhe
13.6. Ushtron edhe detyra e autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me kontratën e punës, dispozitat ligjore dhe aktet e tjera që kanë të bëjnë me Muzeun.

Neni 14

14.1. Kolegjiumi profesional përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen, në konsultim me sektorin e kulturës, nga drejtori i DKRS-së për mandat 3-vjeçar.

14.2. Kolegjiumin profesional e përbëjnë 2 anëtarë nga Muzeu, 1 nga DKRS-ja dhe 2 të jashtëm.

14.3. Kolegjiumi profesional, si organ profesional këshillëdhënës i drejtorit të Muzeut, jep mendime profesionale, lidhur me organizimin e punës dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së Muzeut, shqyrton raportet dhe programet vjetore të veprimtarisë së Muzeut, jep propozime për aftësimin profesional të punonjësve dhe bashkëvepron në përpilimin e punimeve profesionale, të cilat i boton Muzeu.

5. PËRFAQËSIMI

Neni 15.

15.1. Muzeun e prezanton drejtori i tij. Në pamundësi të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të drejtorit, atë mund ta zëvendësojë personi, të cilin, në propozim të shefit të sektorit të kulturës, e cakton drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe, në këtë rast, ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e drejtorit.

6. FINANCIMI I MUZEUT

Neni 16.

Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë së Muzeut, i siguron;
Buxheti i Komunës,

- a) Të ardhurat nga pagesa e vizitorëve të Muzeut;
- b) Të ardhurat nga donacionet, fondacionet, bizneset, OJQ-të e themeluara në Kosovë dhe jashtë saj, pastaj shërbimet me pagesë, të cilat do të shfrytëzohen për pasurimin e fondit të koleksioneve të materialeve muzeore (artefakteve) dhe
- c) Burimet tjera të parapara me ligj dhe me aktet e tjera nënligjore dhe sipas këtij statuti.

7. PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

Neni 17.

17.1. Muzeu harton planin vjetor të punës dhe raportin për punën e bërë. Plani i punës dhe raporti i punës për çdo vit propozohen nga drejtori, pas dhënies së pëlqimit nga sektori i kulturës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 18.

Muzeu planin e punës e harton në pajtim me qëllimet, për të cilat është themeluar, objektivat e synuara, vëllimin, kapacitetet dhe cilësinë e shërbimeve të kryera nga Muzeu dhe në pajtim me politikat zhvillimore të sektorit të kulturës të DKRS-së.

8. NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR

Neni 19.

19.1. Njoftimi i punonjësve bëhet:

- a) Me anë të publikimit të vendimeve të marra në tabelën e shpalljeve të Muzeut dhe
- b) Me kërkesa të secilit punonjës, në mënyrë që t'i jepen shënimet e kërkuara, përkitazi me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësi të tij.

Neni 20.

Transparenca dhe sekretet zyrtar

20.1. Puna e Muzeut është transparente për publikun.

20.2. Transparenca për punën në Muzeut realizohet përmes:

- a) Prezantimi para publikut të interesuar dhe mediave;
- b) Organizimit të ekspozitave;
- c) Bashkëpunimit me individë, institucione dhe organizata të kulturës, arsimit dhe shkencës.

Neni 21.

21.1. Drejtori është i autorizuar që të njoftojë me shkrim, me shtyp, radio dhe TV për çështjet që kanë të bëjnë me punën e Muzeut.

Neni 22.
Sekreti zyrtar

22.1. Sekret zyrtar në Muze janë dokumentacioni, artefaktet dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e Muzeut, DKRS-së dhe të komunës në përgjithësi.

22.2. Sekret zyrtar konsiderohen dokumentacioni dhe shënimet, të cilat janë paraparë me vendim të veçantë të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

9. MBROJTJA DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE

Neni 23.

23.1. Për realizimin e të drejtave të punonjësve të Muzeut kujdesen eprorët e strukturës drejtuese, përkatësisht drejtori i Muzeut, shefi i sektorit dhe drejtori i Drejtisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

23.2. Ndaj vendimit të marrë nga drejtori i Muzeut, shefit të sektorit dhe drejtori i DKRS-së ushtrohet ankesë në Komisionin për ankesa i Komunës së Pejës.

10. AKTET E MUZEUT

Neni 24.

24.1. Në bazë të Statutit të Muzeut, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, Muzeu ka të drejtë të nxjerrë rregullore dhe vendime të brendshme, të cilat duhet të aprovohen nga DKRS-ja, përkatësisht nga sektori i kulturës pranë Drejtorisë për Kulturës, Rini dhe Sport.

24.2. Aktet e caktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të nxirren varësisht prej zhvillimeve në Muze.

24.3. Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të Muzeut.

11. SIGURIA E MUZEUT

Neni 25.

25.1. Objekti dhe pasuria e Muzeut sigurohet 24 orë, 7 ditë në javë,

25.2. Pas orarit të rregullt të punës, për sigurinë e objektit obligohet kompania e sigurimeve fizike, e cila ka fituar tenderin e rregullt për sigurimin fizik të objekteve me rendësi të veçantë për Komunën e Pejës.

12. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26.

26.1. Në rast të mospërputhjeve në mes të dispozitave të këtij Statuti dhe ligjeve, të cilat rregullojnë çështjen e institucioneve të kulturës, përparësi do të kenë dispozitat ligjore kundër atyre të këtij statuti.

Neni 27.

27.1. Ky Statut hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb – faqen e Komunës.

01.Numer: 400 – 85584

Pejë, datë: 30 Janar 2015

KUVENDI KOMUNAL PEJË



**KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj**